



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



M. 2020/11107
Dt. 15.10.21

Nr.660/1 prot.

Shkodër, më 12.10.2021

LËNDA: Mbi vendimin Nr.57, datë 27.09.2021 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, është depozituar për shqyrtim **VKB Vau-Dejës nr.57 datë 27.09.2021** (sipas dokumentacionit shoqërues të mbledhjes së këshillit bashkiak Vau-Dejës të datës 27.09.2021, dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.5619prot datë 4.10.2021)“*Mbi miratimin e rinovimit të kontratës të subjektit “Shimaj-Net” sh.p.k për antenë transmetim interneti në ngastrën nr.15b, ekonomia pyjore Bushat-Bërdicë me sipërfaqe prej 0.0015 ha*”.

Referuar nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54 shkronja e/1, neni 55 pika 3, neni 64, germa c, neni 64/gj të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM Nr.433 datë 08.06.2016 “Për Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” i ndryshuar, shtojcës nr.47, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat dhe procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 22/g, VKM Nr.1064 dt.22.12.2010 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.391 datë 21.06.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm, pasi është në tagrin e këshillit bashkiak të japë në përdorim prona me qëllim nxjerrjen e të ardhurave, e drejtë e cila ushtrohet vetëm nga këshilli, në cilësinë e organit kolegjal.

Lidhja apo nënshkrimi i kontratës në zbatim të nenit 9 pika 1.6/a dhe neni 64/gj të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, është tagër i Kryetarit të Bashkisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ prot.

Vau Dejës, më ____ . ____ .2021

V E N D I M

Nr. 57, datë 27.09.2021

**PËR MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATËS SË SUBJEKTIT "SHIMAJ-NET" Sh.p.k
PËR ANTENË TRANSMETIM INTERNETI.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 27.09.2020, me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "e1", të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 25 pika 1, e ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet" ,pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" ,si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.7.2016 të Ministrisë së Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" ,*me shumicë të cilësuar votash.*

V E N D O S I

1. Miratimin e *rinovimit të kontratës subjektit "Shimaj-Net" sh.p.k për transmetim interneti* në ngastrën nr .15b, ekonomia pyjore Bushat Berdice me sipërfaqe prej 0.0015 ha.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 5 vjecar me të drejtë rinovimi.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti duke rigjeneruar te ardhura , sigurohen të ardhura tek Bashkia të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM nr. 1064, dt. 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".
5. Ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Rural, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

K R Y E T A R
Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 04.10.2021

